

## Vendim nr. 19, datë 21.01.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Marjana Semini,	Anëtare
Asim Vokshi,	Anëtar

në datën 21.01.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 32 (S) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **SADRI GJIDIAJ**, përfaqësuar nga avokat Ilir Dode, me prokurë të posaçme.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-2939, datë 22.07.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 7, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Asim Vokshi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi ka aplikuar për legalizimin e një objekti 1-katësh, të ndërtuar pa leje në qytetin e Durrësit, i cili ndërkohë që ishte në proces legalizimi është prishur nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Durrës (*IMT-ja, Durrës*). Në këto kushte, në datën 08.01.2020 kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, me objekt detyrimin e IMT-së, Durrës që ta dëmshpërblejë atë për prishjen e ndërtesës, në vlerën që do të përcaktonte eksperti vlerësues i caktuar nga gjykata.

2. Në seancën për veprimet përgatitore të datës 15.07.2021, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendim të ndërmjetëm, i ka kërkuar kërkuesit të plotësojë të metat e padisë që konsistonin në: i) depozitimin e provave shkresore që legjitimojnë padinë; ii) përcaktimin e saktë në përmbajte të padisë të fakteve, rrethanave, dokumenteve dhe mjeteve të tjera provuese të së drejtës mbi të cilat është mbështetur padia; iii) përcaktimin konkret në lidhje me shumën që kërkohet si dëmshpërblim; iv) pagimin e tarifës 1% të vlerës së përcaktueshme të objektit të padisë, dukë i lënë afat deri në seancën e radhës të datës 16.09.2021 për plotësimin e të metave të konstatuara. Në seancën e radhës gjykata ka konstatuar se kërkuesi nuk kishte depozituar prova materiale shkresore, për më tepër që avokati i tij ka paraqitur kërkesë për shtyrje seance për arsye shëndetësore.

3. Me vendimin nr. 295 (82-2021-520), datë 16.09.2021, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka vendosur kthimin e padisë kërkuesit, duke e konsideruar të paparaqitur, pasi ka vlerësuar se nuk plotësonte kriteret ligjore të parashikuar nga neni 21 i ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*) dhe neni 154 i Kodit të Procedurës Civile. Kërkesën e avokatit për shtyrjen e seancës gjyqësore, ajo gjykatë e ka vlerësuar të pabazuar, për sa kohë që nga ana e tij nuk është bërë asnjë përpjekje për të plotësuar të metat e padisë, edhe pse i është lënë një afat kohor më se i mjaftueshëm.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 937 (86-2023-1269), datë 23.11.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Lidhur me pretendimin se vlerësimi i të metave të padisë nuk është bërë brenda 7 ditësh nga data e paraqitjes së padisë, gjykata e apelit ka arsyetuar se ky afat nuk është prekluziv dhe se dhënia e këtij vendimi tej afatit 7-ditor nuk passjell pavlefshmëri të tij. Për pretendimin se vendimi në fjalë nuk përcakton se cilat dokumente konkrete duhet të paraqesë pala, gjykata e apelit ka evidentuar se avokati i kërkuesit ka qenë i pranishëm në seancën e parë përgatitore dhe nuk rezulton të mos jetë dakordësuar ose t’i ketë sqaruar gjykatës se kërkuesi nuk ka dokumente të tjera për të paraqitur.

Lidhur me çështjen nëse duhej që gjykata e shkallës së parë të kishte shtyrë seancën për t'i dhënë një mundësi tjetër kërkuarit, gjykata e apelit ka arsyetuar se afati që i është lënë në dispozicion kërkuarit për plotësimin e të metave është 1 muaj i plotë (pa llogaritur muajin gusht), afat i cili tejkalon tri herë afatin 10-ditor të parashikuar nga ligji nr. 49/2012. Po kështu, ajo gjykatë ka konstatuar se periudha e paaftësisë për punë e avokatit të kërkuarit ka qenë shumë më e vogël se afati tërësor që ka pasur në dispozicion, duke konkluduar se nuk është detyrë e gjykatës t'i japë mundësi të përsëritura palës për të bërë rregullime që kanë qenë përgjegjësi e saj që në fillim.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-2939, datë 22.07.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit, pasi ka vlerësuar se ai është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012.

6. Në datën 05.12.2025 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

## II

### Pretendimet e kërkuarit

7. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi gjykata e shkallës së parë e ka konstatuar padinë pa të meta në momentin fillestar dhe e ka njoftuar kërkuarin për këtë. Megjithatë avokati i kërkuarit ka lajmëruar gjykatën për gjendjen e tij shëndetësore, ajo, në shkelje të rëndë të dispozitave procedurale, ka vendosur kthimin e padisë, për më tepër që ligji nr. 49/2012 nuk ka asnjë parashikim se çfarë do të quhet e metë e padisë. Gjithashtu, pavarësisht se vendimi për konstatimin e të metave është një vendim i ndërmjetëm që u komunikohet palëve, ajo gjykatë e ka bërë këtë gjë verbalisht në një seance përgatitore 7 muaj pas paraqitjes së padisë dhe pasi pala e paditur është njoftuar për padinë. Gjykata e apelit ka bërë përcaktim të gabuar të fakteve dhe interpretim të gabuar të ligjit, veçanërisht kur e vlerëson afatin 7-ditor si orientues e rregullues, gjë që e bën atë vendim të pavlefshëm. Ndërsa Gjykata e Lartë mjaftohet me deklarimin se rekursi nuk përmban shkaqe ligjore, duke evituar vlerësimin e shkeljeve të rënda të normave procedurale që passjellin pavlefshmërinë e vendimit. As ajo gjykatë nuk shprehet lidhur me afatin 7-ditor për konstatimin e të metave.

## III

## Vlerësimi i Kolegjit

### A. Për legjitimitimin e kërkuessit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Në verifikim të përmbushjes së kriterëve paraprake, kërkuessi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor që kundërshton, për rrjedhojë ka interes në çështjen e parashtruar.

10. Lidhur me kriterin për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata ka pohuar se mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm për vendime, për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë *subsidiare*, që do të thotë se individ i duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimëve (*shih vendimet nr. 12, datë 18.03.2025; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 75, datë 22.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret Kolegji konstaton se objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi i Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit të veçantë të kërkuessit ndaj vendimit të gjykatës së apelit, ndërkohë në përmbajtjen e ankimit kundërshtohen edhe vendimi i gjykatës së shkallës së parë, me të cilin është vendosur kthimi i padisë së kërkuessit dhe vendimi i gjykatës së apelit që e ka lënë atë në fuqi. Në jurisprudencën e saj, në rastet e vendimeve gjyqësore jopërfundimtare, Gjykata ka pohuar se ato nuk mund të konsiderohen si përfundimtare, për efektet e gjykimit kushtetues, pasi nuk vendosin në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes (*shih vendimet nr. 39, datë 06.07.2016; nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, për vendime të këtij lloji, Gjykata ka pranuar se përjashtimisht ato mund t’i nënshtrohen kontrollit

kushtetues nëse plotësohen disa kritere që lidhen me pasojat e drejtpërdrejta ndaj së drejtës kushtetuese të individit. Në të tilla raste, kërkuesi duhet të provojë se shkelja e pretenduar në rastin konkret është e tillë që justifikon shqyrtimin e çështjes në nivel kushtetues, pasi ajo shkelje dhe pasojat e saj janë të tilla që nuk mund të riparohen më gjatë procesit gjyqësor që është duke u zhvilluar në juridiksionin e zakonshëm (*shih vendimin nr. 59, datë 14.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri legjitimimi, Kolegji vëren se ndonëse kërkuesi nuk pretendon që vendimet gjyqësore të kundërshtuara të jenë përfundimtare, në kuptimin që të kenë vendosur në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes, ai legjitimohet për kundërshtimin e tyre pasi nëpërmjet këtyre vendimeve është mbyllur shqyrtimi i çështjes dhe ky aspekt lidhet me aksesin në gjykatë. Sidoqoftë, Kolegji vëren se vendimi për kthimin e padisë kërkuesit është dhënë nga gjykata e shkallës së parë, pasi, siç është shënuar në të, ai ka dështuar të plotësojë brenda afatit të përcaktuar të metat e padisë të konstatuara prej saj, si: 1) saktësimin e përmbajtjes të padisë; 2) depozitimin e provave shkresore; 3) përcaktimin e shumës që kërkohet si dëmshpërblim; 4) pagimin e tarifës 1% mbi këtë shumë. Padia, sipas parashikimeve ligjore, duhet të përmbajë vlerën e saj të saktësuar fillimisht nga paditësi dhe mbi të të paguhet edhe taksa gjyqësore. Kërkuesi as në ankimin në apel, as në rekursin në Gjykatën e Lartë e as në ankimin e tij kushtetues nuk ka dhënë asnjë shpjegim se përse nuk ka plotësuar që në fillim edhe këto kritere të pranueshmërisë së padisë për shqyrtim, të cilat janë përcaktimi i vlerës së objektit të padisë dhe pagesa e taksës përkatëse gjyqësore, apo pse këto kritere nuk qëndrojnë në rastin konkret. Duke qenë se kërkuesi nuk jep ndonjë shpjegim për to, ndonëse gjykatat kanë marrë për bazë edhe këto mangësi për kthimin e padisë ndaj tij, si dhe nuk i ka kundërshtuar këto shkaqe të kthimit të padisë pranë gjykatave të zakonshme dhe në ankimin e tij kushtetues, Kolegji vlerëson se nuk ka shteruar mjetet e ankimit në lidhje me këtë element, duke u bërë kërkimi i tij i papranueshëm.

13. Lidhur me pretendimin e për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektin e së drejtës së aksesit të lidhur me *standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, nuk qëndron argumenti i kërkuesit se gjykata e shkallës së parë e ka vlerësuar fillimisht padinë pa të meta, pasi rezulton se pavarësisht se çështja ka marrë kohë relativisht të gjatë (në raport me afatet e gjykimit sipas ligjit nr. 49/2012), konstatimi i të metave është bërë në fazën e veprimeve përgatitore, siç thuhet shprehimisht në vendimin nr. 295, datë 16.09.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

14. Nga ana tjetër, për sa i përket pretendimit të kërkuarit për qenien e avokatit të tij në pamundësi për shkaqe mjekësore për të marrë pjesë në seancën përgatitore të caktuar nga gjykata për plotësimin e të metave të kërkesëpadisë, Kolegji e gjen atë haptazi të pabazuar, pasi, siç kanë arsyetuar gjykatat, koha e pamundësisë fizike të avokatit ka qenë shumë e vogël në raport me afatin mbi një muaj të lënë për plotësimin e të metave të kërkesëpadisë, për më tepër që këto të meta lidheshin me aspekte që mund të plotësoheshin edhe me shkresë drejtuar gjykatës. Avokati i kërkuarit, nga njëra anë, i ka dërguar shkresë gjykatës për shtyrjen e gjykimit, ndërkohë që, nga ana tjetër, nuk është përpjekur as minimalisht të kërkojë kohë shtesë për plotësimin e të metave të kërkesëpadisë, njëkohësisht me shpjegimin ndaj gjykatës se pse nuk kishte plotësuar në kohë të metat e konstatuara nga gjykata në seancën pararendëse. Gjykimi në gjykatën administrative mund të zhvillohet edhe në mungesë të palës, por plotësimi i të metave të kërkesëpadisë brenda afatit të caktuar nga gjykata nevojitet të realizohet me përpikëri ose t'i tregohen gjykatës arsye objektive që kanë penguar palën ose avokatin e saj që të plotësojë në kohë të metat e konstatuara. Gjykata Administrative e Apelit u ka kthyer përgjigje të argumentuar pretendimeve të kërkuarit, në lidhje me pamundësinë e avokatit, i cili ka pasur kohë të mjaftueshme gjatë periudhës që nuk ka pasur probleme shëndetësore që të plotësonin të metat e kërkesëpadisë, veçanërisht në lidhje me përcaktimin e vlerës së objektit të padisë dhe pagimin e tarifës përkatëse gjyqësore, të cilat i ishin lënë detyrë nga gjykata në seancën përgatitore të datës 15.07.2021, ku avokati ka qenë i pranishëm. Në këtë mënyrë, rezulton haptazi i papranueshëm edhe pretendimi i kërkuarit se nuk ka marrë dijeni asnjëherë për lënien afat për plotësimin e të metave të kërkesëpadisë.

15. Kolegji vlerëson se kërkuari nuk ka arritur të provojë se shkeljet e pretenduara në rastin konkret janë të tilla që të justifikojnë shqyrtimin e çështjes në nivel kushtetues. Ai nuk ka argumentuar se përse shkelja e supozuar e së drejtës së aksesit është e tillë që nuk mund të riparohej me mjetet dhe rrugët e tjera ligjore të garantuara nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, siç është plotësimi në kohë i të metave të padisë ose riparimitja e saj brenda afateve ligjore. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se në rastin konkret nuk plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive, për shkak të moskundërshtimit para gjykatave të zakonshme të të gjitha shkaqeve për kthimin e padisë, si dhe për shkak të qenies haptazi të pabazuara të pretendimeve të tjera të kërkuarit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor.

16. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.